



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR MINISTRINË E ADMINISTRIMIT TË
PUSHTETIT LOKAL
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Qerkin Morina, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Erëmira Bytyqi Pllana (udhëheqës ekipi) dhe Mazllumsha Sejadini (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	11
4 Qeverisja e mirë.....	18
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Komentet e ministrisë në gjetjet e raportit të auditimit	27

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare Vjetore për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 26.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i MAPL-së.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj, për faktin se pasuritë jofinanciare kapitale, përkatësisht investimet në vijim të ministrisë, nuk ishin shpalosur në mënyrë të drejtë në PFV, pasi ato ishin nënvlerësuar për shumën prej 739,018€.

Më gjerësisht, shih kapitullin 2.1 të raportit.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2018**

Ministri është pajtuar me pjesën më të madhe të gjetjeve dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj të gjitha rekomandimet e dhëna. Komentet për çështjen për të cilën ministria nuk është pajtuar, mund ta gjeni në Shtojcën II.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Ministrisë gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase.
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Ministrisë, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se pasuritë jo financiare kapitale përkatësisht investimet në vijim të shpalosura në nenin 19.3.1 në PFV, ishin nënvlerësuar për vlerën 739,018€.

Gjatë vitit 2018, MAPL në bazë të marrëveshjeve të bashkëfinancimit me komunat, kishte financuar projekte të ndryshme kapitale për komunat e Republikës së Kosovës. Këto financime, MAPL i kishte regjistruar në regjistrin e pasurive të saj si investime në vijim. Pas kryerjes së obligimit të ministrisë, përkatësisht pagesës së fundit, MAPL kishte kërkuar nga Ministria e Financave (MF) që të largohen këto investime në vijim nga regjistrat e pasurisë me arsyetimin se e kishte kryer obligimin e vet

financiar, si dhe kishte njoftuar komunat për tërheqjen e dokumentacionit të pagesave. Me këtë rast, MF, kishte shlyer projektet nga regjistri i pasurisë së MAPL-së edhe pse ato nuk ishin përfunduar dhe nuk ishte bërë pranimi teknik i tyre. Si rrjedhojë, këto investime në vijim nuk figuronin në asnjë nga regjistrat e pasurive, as si investime, e as si pasuri.

Kjo nuk ishte në pajtim me nenin 12 të Rregullores MF. Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore e cila përcakton se: “Deri në momentin e pranimin të pasurisë jo financiare organizatat buxhetore financuese do të regjistrojnë transaksionet në kategorinë e investimeve në vijim. Në momentin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e pranimin nga ana e organizatës buxhetore, e cila e fiton të drejtën e pronësisë mbi pasurinë përkatëse, atëherë kategoria e investimeve në vijim mbyllet edhe në regjistrat e organizatës buxhetore pranuese dhe organizatës buxhetore bashkëfinancuese”.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos zbatimit të rregullores për menaxhimin e pasurive jo financiare si dhe mos respektimin e marrëveshjeve të mirëkuptimit me komunat lidhur me mënyrën e bartjes së pronësisë së projektit nga ana e zyrtarëve përgjegjës të ministrisë.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është

relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

MAPL, kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr.01/2013/MF-shpenzimi i parave publike, si dhe Rregulloren MF nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore;
- Planin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara publike;
- Raportet financiare tre-mujore, raportet operative;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK).

Draft PFV-të e ministrisë ishin keq deklaruar me vlera materiale nëpër zërat kryesor, por pas sugjerimeve tona ato ishin korrigjuar me 22.02.2019.

Lidhur me PFV-të, përveç çështjes së ngritur tek Theksimi i Çështjes, ne kemi identifikuar se MAPL, nuk kishte shpalosur në mënyrë të drejtë obligimet e papaguara dhe pasuritë jo financiare jokapitale, si në vijim:

Neni 17 - Raporti për detyrimet e papaguara, të cilat ishin nënvlerësuar për vlerën prej 2,819€. Kjo, për shkak se dy fatura të muajit dhjetor 2018, që kishin të bënin me shpenzime të qirasë për automjete dhe shpenzime të karburantit, e të cilat ishin pranuar në MAPL në muajin janar 2019, nuk ishin paraqitur si obligime në PFV. Kjo ishte në kundërshtim me Rregulloren MF. nr. 01/2017, për raportim vjetor financiar nga OB, neni 17, raporti për detyrimet (faturat) e papaguara, ku kërkohet që organizatat buxhetore t'i raportojnë të gjitha detyrimet (faturat) të krijuara deri më 31 dhjetor të vitit raportues.

Kjo kishte ndodhur për shkak se zyrtari përgjegjës i financave nuk kishte pasur njohuri se faturat që pranohen pas përfundimit të vitit fiskal duhet të paraqiten si obligime të papaguara në pasqyrat financiare vjetore.

Neni 19.3.2- Pasuritë jokapitale me vlerë nën 1,000€: Pasuritë jo financiare jo kapitale të shpalosura në vlerë 140,360€ ishin të mbivlerësuar. Kjo pasi për pasurinë e regjistruar në vlerë 24,320€ në mars të vitit 2018, e rivlerësuar nga komisioni i vlerësimit, nuk ishte aplikuar zhvlerësimi në fund të vitit. Kjo ishte në kundërshtim me rregulloren MF 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në OB, neni 20, sipas të cilës të gjitha pasuritë jo financiare kapitale dhe jo kapitale do t'i nënshtrohen normave të zhvlerësimit.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos aplikimit të zhvlerësimit në mënyrë automatike nga MAP dhe mungesës së zyrtarit përgjegjës për mirëmbajtjen e regjistrit të pasurive jokapitale.

DEKLARATA E BËRË NGA ZYRTARI KRYESOR ADMINISTRATIV DHE AI FINANCIAR

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, përveç për çështjet e cekura më lartë mund të konsiderohet saktë.

Lidhur me kërkesat tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi A1 Ministri duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet përmes bashkëfinancimit me komunat, të cilat regjistrohen si investime në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë, nuk fshihen nga regjistrat, derisa këto projekte përfundohen dhe kalojnë në pronësi të komunës përfituese.

Ministri duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara prezantohen drejtë dhe saktë në PVF, siç kërkohet me rregullat e thesarit për raportimin financiar.

Ministri duhet të siguroj se janë marrë masat e duhura për adresimin e problemeve lidhur me zhvlerësimin, në mënyrë që zyrtari i pasurisë mirëmban regjistrin duke aplikuar zhvlerësimin sipas normave të përcaktuara, në bashkëpunim me MAP.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, në MAPL kontrollet mbi shpenzimet në përgjithësi janë zbatuar në mënyrë efektive, megjithatë në disa raste kemi identifikuar mangësi që kanë nevojë për përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar parregullsinë e shpenzimeve. Mos zbatimi me konsistencë i rregulloreve nga një pjesë e stafit, ka ndikuar në paraqitjen e mangësive në disa raste. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi dhe realizimi i buxhetit, kontrollet në mbylljen e avanceve, shpenzimi i buxhetit nga kodet përkatëse dhe në përputhje me kërkesat ligjore, menaxhimi i regjistrave të pasurive të ministrisë si dhe vendosja e kontrolleve në fushën e prokurimit.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	5,102,461	4,952,395	4,834,107	4,434,677	4,808,764
Granti i Qeverisë -Buxheti	5,102,461	4,682,430	4,676,584	4,331,066	4,696,680
Donacionet e jashtme	0	269,965	157,523	103,611	112,084

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 150,066€. Ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë mbi deklarinin e kursimeve/mjeteve të pashpenzuara në fund të vitit, në të gjitha kategoritë, me theks të veçantë tek investimet kapitale.

Në vitin 2018, MAPL ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 4,834,107€. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

¹ Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	5,102,461	4,952,395	4,834,107	4,434,677	4,808,764
Pagat dhe Mëditjet	998,882	1,059,866	1,018,893	971,081	918,917
Mallrat dhe Shërbimet	264,430	305,432	242,033	192,284	345,231
Shërbimet komunale	15,500	21,935	12,547	11,895	11,134
Subvencionet dhe Transferet	50,000	46,980	46,815	184,611	197,624
Investimet Kapitale	3,773,649	3,518,182	3,513,819	3,074,806	3,335,858

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore përfshirë arsyet dhe ndikim që kanë pasur:

- Buxheti final për paga dhe mëditje për dallim nga buxheti fillestar ishte rritur për 60,984€. Kjo rritje vjen si rezultat i granteve të donatorëve në vlerë 106,773€ dhe rritjes prej 5,037€ me vendim të Qeverisë nr.07/80, për rritje të pagave për kabinetin politik, ndërsa më pas zvogëlimit të buxhetit në vlerë 50,826€, me vendim të Qeverisë nr. 02/70 të datës 19.10.2018 lidhur me deklarin e kursimeve nga MAPL. Realizimi në këtë kategori ishte 96%.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime kishte rritje në krahasim me buxhetin fillestar për 41,002€. Kjo rritje ishte si rezultat i granteve të donatorëve në vlerë 153,821€, si dhe zvogëlimit të buxhetit në vlerë 112,819€, sipas vendimit të Qeverisë nr.04/82 të datës 28.12.2018. Përkundër rritjes, buxheti ishte realizuar vetëm 79%.
- Tek shpenzimet komunale, buxheti kishte rritje për 6,435€. Kjo ishte si rezultat i rritjes së buxhetit nga grantet e donatorëve për 9,372€, dhe reduktimit të buxhetit në vlerë 2,937€, sipas vendimit të Qeverisë nr.07/80 të datës 18.12.2018. Buxheti ishte realizuar ishte vetëm 57%.
- Subvencionet dhe transferet kishin pësuar një zvogëlim prej 3,020€ me vendim të Qeverisë nr. 07/80 të datës 18.12.2018. Realizimi në këtë kategori ishte në nivel prej 99%.
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 255,467€, sipas vendimeve të Qeverisë². Kjo, pasi MAPL nuk kishte arritur të realizoj në tërësi projektet e planifikuara lidhur me investimet kapitale në komuna. Mangësitë në këtë pikë kishin rrjedhur fillimisht si rezultat i nënshkrimit me vonesë të marrëveshjeve të mirëkuptimit, e më pas kishin pasuar vonesat në realizimin e procedurave të prokurimit nga komunat dhe fillimi i vonshëm i punimeve.

² Vendimi i Qeverisë nr.04/70 të datës 19.10.2018 me deklarin të kursimeve, është zvogëluar në vlerë prej 41,954€; Vendim i Qeverisë me nr.11/79 të datës 11.12.2018 me deklarin të kursimeve, është zvogëluar në vlerë prej 22,235€; Vendim i Qeverisë me nr.07/80 të datës 18.12.2018 është zvogëluar për 17,202€ dhe Vendim i Qeverisë me nr.04/82 të datës 28.12.2018 është zvogëluar për 174,076€.

Çështja A2 - Keq klasifikimi i shpenzimeve

Gjetja Sipas Rregullës Financiare 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, shpenzimet duhet të regjistrohen sipas kodeve adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) për planin kontabël. Bazuar në UA nr. 2005/08, kategoria e mallrave dhe shërbimeve ndër të tjera përfshin pajisjet në vlerë deri në 1,000€ edhe nëse afati i përdorimit mund të jetë më tepër se një vit.

Pagesa në vlerë 82,798€ për kontratën “Furnizim me pajisje për TI për komunat” ishte realizuar nga investimet kapitale, ndonëse shuma prej 48,814€, kishte të bënte me kompjuterë dhe pajisje tjera nën 1,000€ (laptopë, skaner dhe fotoaparate), të dedikuara për zyrtarë nga komunat dhe zyrtarë brenda ministrisë, të cilat do të duhej të realizoheshin nga mallrat dhe shërbimet.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimit jo të drejtë të shpenzimeve në kategoritë përkatëse.

Rreziku Pagesa e mallrave dhe shërbimeve nga investimet kapitale, reflekton një pasqyrë jo të drejtë të shpenzimit të buxhetit të ministrisë, duke mbivlerësuar investimet kapitale dhe nënvlerësuar mallrat dhe shërbimet.

Rekomandimi A2 Ministri të siguroj se bëhet një planifikim i duhur i buxhetit bazuar në nevojat e ministrisë në kategoritë adekuate, duke marrë për bazë planin kontabël të aprovuar nga MF.

Çështja B1 - Realizim i ulët i buxhetit në kategoritë mallra dhe shërbime, dhe komunal

Gjetja MAPL, nuk kishte arritur të shpenzoj në nivelin e planifikuar buxhetin për mallra dhe shërbime, duke shpenzuar vetëm 79%, si dhe atë për komunal 57%. Kjo kishte ndodhur për shkak të dështimit të planeve dhe projekteve të synuara lidhur me shfrytëzimin e buxhetit të këtyre kategorive.

Rreziku Mosefikasiteti në shpenzimin e buxhetit në kategoritë përkatëse ndikon në mos arritjen e objektivave të ministrisë dhe reduktimin e planeve buxhetore në vitet e ardhme.

Rekomandimi B1 Ministri duhet të rishikoj shkaqet e mos realizimit të buxhetit dhe të ndërmerr veprime përmirësuese në fushat ku projektet kanë dështuar të realizohen. Performanca buxhetore duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.

3.1.1 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 1,059,866€, ndërsa ishin shpenzuar 1,018,893€ apo 96%.

Çështja A3 - Mungesa e evidencave për vijueshmërinë në punë

E gjetura

Ne kemi trajtuar një numër mostrash lidhur me vijueshmërinë në punë të stafit të MAPL. Duke u bazuar në marrëveshjen e Brukselit, përkatësisht në Ligjin nr.04/L-199 për ratifikimin e marrëveshjes së parë ndërkombëtare të parimeve që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë, Qeveria e Kosovës me vendim nr. 06/39 të datës 22.07.2015, ka aprovuar konkluzionet e dakorduara për Shpërbërjen e të ashtuquajturës "Mbrojta Civile" e cila ka funksionuar në komunat veriore të Kosovës, si dhe mbështet zotimet e përcaktuara me këto konkluzione. Përmes këtij vendimi, obligohen ministritë dhe agjencitë përkatëse që të bëjnë zbatimin e konkluzioneve sipas përgjegjësisë ligjore.

Në MAPL pas një procesi të rekrutimit me akt emërimi ishin integruar 18 nëpunës të komunitetit serb, ish pjesëtarë të "Mbrojtjes Civile". Këta punonjës ishin planifikuar të sistemohen nëpunë komunitat në pjesën veriore të Kosovës. Megjithatë, në aktemërimet e tyre, të punësuarit janë sistemuar në pozita të caktuara brenda departamenteve përkatëse në ministri.

Për zyrtarët e lartcekur ministria, nuk ka dëshmi për ta konfirmuar paraqitjen e tyre në vendin e punës, siç i obligon rregullorja nr. 05/2010 e orarit të punës, përderisa ministria kishte bërë pagesën e rregullt të pagave të tyre. Vlera financiare për shpenzimet e pagave për vitin 2018, për 18 zyrtarë ishte 81,156€.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk janë zbatuar kontrole menaxheriale për të siguruar se të gjithë të punësuarit janë të pranishëm në vendin e punës gjatë orarit të punës.

Rreziku

Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë, nuk kanë bazë të qartë ligjore dhe nuk janë pagesa të rregullta. Si të tilla, mund ta dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

Rekomandimi A3 Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar kushte pune dhe vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri, duke qenë se problemi si i tillë është mjaft i përhapur edhe në ministritë tjera.

3.1.2 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale në vitin 2018 ishte 327,367€. Prej tyre ishin shpenzuar 254,579€. Ato kanë të bëjnë me servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve, blerja e inventarit dhe pajisje të TI-së, furnizim për zyre, shërbime kontraktuese, shpenzime të udhëtimit, shpenzime të reprezentacionit etj.

Çështja A4 – Avancet e pambyllura nga vitet paraprake

Gjetja Në bazë të rregullës financiare nr. 01/2013 MF-shpenzimi i parave publike dhe udhëzimit administrativ për udhëtime zyrtare nr.MSHP 2004/7, avancet për udhëtime zyrtare duhet të mbyllen dhe shumat e pa shpenzuara duhet të kthehen në llogarinë bankare brenda 15 ditësh pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

MAPL, në PFV (neni 20), kishte paraqitur vlerën prej 6,832€, avance të paarsyetuara për udhëtime zyrtare dhe para të imëta. Prej tyre, vlera prej 5,945€, ishin avance të pambyllura nga vitet paraprake³ dhe 887€ avance në para të imtë. MAPL, kishte dokumentet që tregonin mbylljen e avanceve, mirëpo në SIMFK ato ende figurojnë të hapura. MAPL, kishte bërë kërkesë në Thesar për t'i korigjuar avancet e mëhershme, duke dërguar dokumentacionin e duhur, si dhe ishte në pritje të korrigjimit të pjesës së mbetur të avanceve të hapura nga Thesari.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mos koordinimit të mirë në mes të zyrtarit financiar të MAPL dhe Thesarit.

Rreziku Mungesa e kontroleve të duhura lidhur me avancet rrit rrezikun që të mos evitohen gabimet në llogarinë e avanceve dhe llogaria të mbetet e hapur.

Rekomandimi A4 Ministri të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura në menaxhimin e vazhdueshëm të llogarisë së avanseve si dhe të vazhdoj bashkëpunimin me thesarin, në mënyrë që në afatin më të shkurtër të mbyllë pjesën e mbetur të avanseve të hapura.

3.1.3 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 46,980€. Prej tyre, në 2018 ishin shpenzuar 46,815€. Ato kanë të bëjnë me mbështetjen financiare të projekteve të OJQ-ve lidhur me avancimin e vetëqeverisjes lokale në Kosovë.

³ Avance të pambyllura nga vitet 2010-2014.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,518,182€. Prej tyre, në 2018 ishin shpenzuar 3,513,819€. Ato kanë të bëjnë me katër projekte të aprovuara në PIP, si: (a) Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve bazuar në performancën komunale; (b) Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio ekonomike; (c) Fondi stimulues dhe (d) Pajisje për TI për komunat.

Çështja A5 - Pagesa e bërë në bazë të marrëveshjes për ndarjen e kostove

Gjetja Sipas nenit 22 të rregullës financiare nr. 01/2013/MF shpenzimi i parave publike, për procedim të një pagese kërkohet dokumentacioni përkatës përfshirë raportin e pranimit dhe faturën.

Në marrëveshjen për ndarje të shpenzimeve mes UNDP dhe MAPL, e lidhur me datë 09.08.2018, është përcaktuar që MAPL do të paguaj në avanc vlerën prej 20,000€, për dizajnimin e platformës online. Në këtë marrëveshje nuk përcaktohet vlera e kontributit nga ana e UNDP-së, ndërsa platforma parashihet të mbetet pronë e MAPL-së. Si rezultat, MAPL kishte bërë pagesën në vlerë 20,000€, në llogari të UNDP-së, duke e regjistruar si shpenzim në kodin softuer, pa pasur faturë, dhe raport për pranimin e mallit (shërbimet)/punët e kryera, dhe jo nga kodi avanc për investime kapitale, siç është e paraparë në planin kontabël. Për më tepër, marrëveshja nuk parashihte afate të qarta për realizimin e projektit. Ndonëse, pagesa ishte bërë në muajin gusht, deri në fund të vitit 2018, MAPL nuk kishte pranuar raporte financiare apo narrative lidhur me progresin e projektit, pasi deri në këtë periudhë projekti nuk kishte filluar të zbatohet.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mos njohurisë me kërkesat e ligjeve/rregullave financiare nga zyrtarët përgjegjës të ministrisë.

Rreziku Pagesa totale e pjesës së financuar nga MAPL, jo në pajtim me rregullën për shpenzimin e parave publike dhe në mungesë të afateve të qarta për zbatim, rritë rrezikun e realizimit të objektivave të ministrisë. Po ashtu, kjo nuk tregon një pasqyrë të drejtë të shpenzimit për shkak të mbivlerësimit të shpenzimeve kapitale dhe nënvlerësimit të pasurive jo financiare kapitale.

Rekomandimi A5 Ministri, të siguroj se marrëveshjet e bashkëfinancimit, përmbajnë afatet e qarta kohore për zbatim të projektit dhe të gjitha transaksionet financiare bëhen në pajtim me procedurat dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.

Çështja A6 Përgatitja e dosjes së tenderit në mospërputhje të plotë me specifikacionin teknik

E gjetura Bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ, pika 11.3, përcakton se “zyrtari përgjegjës i zyrës së prokurimit në bashkëpunim me njësinë kërkuese do të koordinojë specifikimet, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë”.

Zyra e prokurimit në MAPL, me rastin e përgatitjes së dosjes së tenderit për kontratën “Furnizim me pajisje të TI për komuna “ në vlerë 82,798€ pas pranimit të specifikacionit teknik nga komisioni i caktuar për përgatitjen e tij, kishte ndërhyrë në modifikimin e tij duke shtuar një pozicion shtesë (trajnimi i stafit) në vlerë 1,000€, përderisa ky pozicion kishte qenë i përfshirë në një pikë tjetër së bashku me montimin dhe instalimin e pajisjeve, po ashtu me vlerë 1000€. Në këtë mënyrë, OE kishte ofertuar për dy pozicionet ku përfshihet kërkesa e njëjtë, siç është trajnimi i stafit.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e pakujdesisë nga zyrtari i prokurimit, për të harmonizuar specifikacionin e dosjes së tenderit, me kërkesat e specifikave të hartuara nga komisioni.

Rreziku Modifikimi i specifikacionit teknik nga zyra e prokurimit pa një koordinim me komisionin e hartimit të specifikave, rrezikon dyfishimin e pozicioneve në dosje të tenderit, që në këtë rast ka rezultuar me pagesë të dyfishtë për shërbimin e njëjtë.

Rekomandimi A6 Ministri duhet të siguroj se zyrtari përgjegjës i prokurimit, gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit ndjekë rregullat mbi përgjegjësitë e tij në përgatitjen e dosjes së tenderit, duke mos ndërhyrë në modifikimin e specifikacionit teknik pa një bashkëpunim të mirëfilltë me njësinë apo komisionin që ka përgatitur specifikacionin teknik.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Sipas PFV-ve të ministrisë, pasuritë kapitale ishin shpалosur në vlerë 99,537€, ndërsa ato jokapitale në vlerë 140,360€. Çështjet lidhur me vlerën e shpалosur të pasurive kapitale në PFV, i kemi trajtuar tek kapitulli i Opinionit të Auditimit - Theksimi i Çështjes, derisa ato për pasuritë jokapitale tek kapitulli 2.2- Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim.

3.3 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2018 ishte 449€. Kjo vlerë ka rezultuar të jetë e nënvlerësuar dhe këtë e kemi trajtuar tek kapitulli 2.2-Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim. Këto obligime janë bartur për t’u paguar në vitin 2019.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Qeverisja në MAPL, në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Zyrtari Kryesor Administrativ pranon raporte të rregullta javore nga departamentet, si dhe raporte javore individuale. Ministria, po ashtu, ka hartuar regjistrin e rreziqeve ku ka identifikuar rreziqet në nivel të departamenteve, gjasat e ndodhjes, masat/veprimet që duhet të ndërmerren.

MAPL, ka vendosur objektivat e saj në Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale (SVQL) 2016 – 2026 dhe monitoron përmbushjen e tyre përmes planit të veprimit për implementim të SVQL 2016-2026 si dhe planit vjetor të punës së MAPL-së për vitin 2018. Ministria tanimë ka të aprovuar Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal, e cila ka qenë një ndër prioritetet në planin e veprimit për zbatimin e programit të Qeverisë.

Ministria ka arritur të shpenzoj buxhetin e saj në nivel të kënaqshëm, përveç në fushën e mallrave dhe shërbimeve, si dhe komunalive ku ka një realizim më të dobët. Sa i përket investimeve kapitale, ministria nuk kishte arritur që t'i realizoj sipas planit projektet e saj lidhur me zhvillimin e infrastrukturës në komuna, si rezultat i nënshkrimit me vonesë të marrëveshjeve të mirëkuptimit, dhe vonesave në realizimin e procedurave të prokurimit nga komunat, ku si pasojë 74% e buxhetit ishte shpenzuar në dy muajt e fundit të vitit, ndërsa një pjesë e mjeteve në fund të vitit nga kjo kategori, ishte tërhequr me vendim të Qeverisë për deklarim të kursimeve në kategoritë buxhetore..

Auditimi i Brendshëm kishte ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e sigurisë së kontrolleve të brendshme dhe kishte dhënë rekomandime për përmirësimin e tyre.

MAPL, ka përmbushur kërkesën e MF lidhur me dorëzimin e pyetësorit të vetëvlerësimit.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë - Drejtori i NjAB dhe dy auditorë. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës i punës që reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të entitetit të audituar dhe që ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm.

NjAB, ka përgatitur planin strategjik (2018-2020) dhe planin vjetor, të cilët ishin aprovuar nga kryesuesja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm. Plani vjetor i punës ishte hartuar në përputhje me planin strategjik. Në planin vjetor janë planifikuar gjashtë auditime, të cilat mbulojnë periudhën e vitit 2018.

NJAB kishte finalizuar gjithsej shtatë (7) auditime, gjashtë (6) prej të cilave ishin auditime të planifikuara dhe një (1) auditim me kërkesë të menaxhmentit të ministrisë⁴.

Përveç finalizimit me kohë të raporteve ato ishin mjaft cilësore dhe përmbajtësore. Raportet e auditimit përmbajnë konkluzione dhe rekomandime të cilat identifikojnë disa nga mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të MAPL-së. Numri i rekomandimeve të dhëna gjithsej ishte 46, prej tyre ishin zbatuar 23, në proces të zbatimit ishin 16 dhe 7 rekomandime nuk janë zbatuar.

NJAB, kishte raportuar në baza të rregullta edhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese të Auditimit të Brendshëm.

Puna e NJAB-it është mbikëqyrur nga Komitetit i auditimit, i cili kishte mbajtur tri takime ku ishin diskutuar raportet e NJAB-së. Gjithashtu, ky komitet kishte përgatitur raportin e punës për vitin 2018 të cilin ia kishte dërguar menaxhmentit të ministrisë.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një

⁴ Raportet e finalizuara: (1) Sistemi i menaxhimit të buxhetit Faza e I-rë; (2) Menaxhimi i automjeteve; (3) Sistemi i menaxhimit të prokurimit; (4) Sistemi i menaxhimit të pagave; (5) Sistemi i menaxhimit të buxhetit Faza II-të; (6) Sistemi i menaxhimit të investimeve kapitale; dhe (7) Auditimi me kërkesë të menaxhmentit.

proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti pranon raporte javore individuale dhe në bazë të departamentit, si dhe mban takime në baza të rregullta javore, të dëshmuara me procesverbale.

Menaxhimi i rreziqeve është shoqëruar me raportin e monitorimit mbi zbatimin e listës së rreziqeve për periudhën gjashtë-mujore dhe vjetore.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara nuk qenë mjaftueshëm efektive pasi në disa raste nuk kanë mundur një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuar. Lidhur me çështjet e identifikuar ku kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar, janë dhënë rekomandimet në kapitujt më lartë të raportit.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të MAPL-së është kryer nga kompania private "Deloitte Kosova Sh.p.k" e kontraktuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Ky raport ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit për vitin 2018, pesë (5) rekomandime janë zbatuar; ndërsa një (1) nuk është adresuar ende. Ndonëse MAPL ka ndërmarrë veprime për një monitorim më të mirë të ecurive buxhetore gjatë vitit, rekomandimi sa i përket realizimit të buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe komunalit mbetet i pazbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

Nr .	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarr a	Statusi
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Ministri duhet të sigurojë që monitorimi i performancës buxhetore të forcohet dhe të zgjerohet edhe më tej. Kur supozimet e buxhetit fillestar janë të pasakta, ajo duhet të pasqyrohet plotësisht në buxhetin përfundimtar.	Nuk janë ndërmarrë veprime të mjaftueshme në këtë drejtim pasi realizimi i buxhetit në fushat e identifikuar nuk është në nivelin e pritur	Rekomandim i pazbatuar
2	Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale	Ne rekomandojmë që njësia të fuqizojë kontrollet në procesin e prokurimit dhe të planifikojë dhe të zotojë siç duhet fondet e nevojshme për shërbimet e përfituara ose mallrat e blera.	Në mostrat tona për investime kapitale dhe mallra dhe shërbime, mjetet janë zotuar në shumën e duhur.	Rekomandim i zbatuar
3	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ne rekomandojmë Ministrinë të sigurojë që të mirëmbahen të dhënat përkatëse për pasuritë nën menaxhim dhe ato shënime të jenë të shpalosura siç duhet në pasqyrat financiare	Pasuritë e nënvlerësuar janë regjistruar në e-pasuri në mars të vitit 2018.	Rekomandim i zbatuar

4	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Ne i rekomandojmë Ministrisë të mbajë një inventarizim për të gjitha pasuritë që zotërohen dhe të përgatisë një raport me rezultate mbi procesin dhe të pasqyrojë këto rezultate në sistemin e kontabilitetit.	Inventarizimi ka përfshirë edhe pasuritë mbi 1,000€.	Rekomandim i zbatuar
5	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.	Plani i veprimit ka përcaktuar afatet kohore për implementim. Nga gjithsej gjashtë rekomandime të dhëna në vitin paraprak, vetëm një rekomandim nuk është zbatuar.	Rekomandim i zbatuar
6	Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut	Performanca buxhetore, duke përfshirë të hyrat dhe shpenzimet, duhet të jenë subjekt i raportimeve dhe rishikimeve të rregullta nga ana e menaxhmentit.	Menaxhmenti është informuar me raporte të rregullta.	Rekomandim i zbatuar
Nr	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
A1	PFV	Ministri, duhet të siguroj se pagesat e realizuara për projektet përmes bashkëfinancimit me komunat, të cilat regjistrohen si investime në vijim në regjistrin e pasurive të ministrisë, nuk fshihen nga regjistrat, derisa këto pasuri pranohen teknikisht dhe kalojnë në pronësi të komunës përfituese. Ministri, duhet të siguroj se të gjitha obligimet e papaguara prezantohen drejtë dhe saktë në PVF siç kërkohet me rregullat e thesarit për raportimin financiar.		

		Ministri, duhet të siguroj se janë marrë masat e duhura për adresimin e problemeve lidhur me zhvlerësimin, në mënyrë që zyrtari i pasurisë mirëmban regjistrin duke aplikuar zhvlerësimin sipas normave të përcaktuara, në bashkëpunim me MAP.
A2	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Ministri, të siguroj se bëhet një planifikim i duhur i buxhetit bazuar në nevojat e ministrisë në kategoritë adekuate, duke marrë për bazë planin kontabël të aprovuar nga MF.
B1	Planifikim i dhe realizimi i buxhetit	Ministri të rishikoj shkaqet e mos realizimit të buxhetit dhe të ndërmerr veprime përmirësuese në fushat ku projektet kanë dështuar të realizohen. Performanca buxhetore duhet të jetë subjekt i rishikimit dhe monitorimit të rregullt nga menaxhmenti.
A3	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet për të siguruar vijueshmërinë e rregullt në punë të këtyre punonjësve, duke bërë monitorimin e vazhdueshëm ashtu siç parashihet me aktet ligjore. Në të kundërtën, këtë problem ta diskutoj edhe në Qeveri duke qenë se ky problem është i përhapur edhe në ministrinë tjera.
A4	Mallrat dhe shërbimet	Ministri, të siguroj se janë vendosur kontrollet e duhura në menaxhimin e vazhdueshëm të llogarisë së avanseve si dhe të vazhdoj bashkëpunimin me thesarin, në mënyrë që në afatin më të shkurtër të mbyllë pjesën e mbetur të avanseve të hapura.
A5	Investimet Kapitale	Ministri, të siguroj se marrëveshjet e bashkëfinancimit, përmbajnë afatet e qarta kohore për implementim të projektit dhe të gjitha transaksionet financiare bëhen në pajtim me procedurat dhe rregullat financiare për shpenzimin e parave publike.
A6	Investimet Kapitale	Ministri të siguroj se zyrtari përgjegjës i prokurimit, gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit ndjek rregullat mbi përgjegjësitë e tij në përgatitjen e dosjes së tenderit, duke mos ndërhyrë në modifikimin e specifikacionit teknik pa një bashkëpunim të mirëfilltë me njësinë apo komisionin që ka përgatitur specifikacionin teknik.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Komentet e ministrisë në gjetjet e raportit të auditimit

Gjetjet/ çështjet	Pajtohe mi po/jo	Komenti i ministrisë	Pikëpamjet e ZKA-së
Çështja 5:	JO	<p>Ne lidhje me këtë pagese MAPL ka ofruar dëshmitë gjate Auditimit: Marrëveshjen e Mirëkuptimit në mes të MAPL-se dhe UNDP-se, MM te MAPL-së me Ambasadën Britanike, ToR-in, buxhetin e propozuar, diagramet, progresin e projektit, ABB raportin financiar, planin e punës. MAPL ka ndjekur praktikat nga vitet e kaluara në lidhje me këto pagesa si në rastet në vijim.</p> <p>Komisioni Evropian</p> <p>MAPL ka nënshkruar Grant Contract External Actions of the Eropean Union TA.Granti për programin e bashkëpunimit ndërkufitar në mes të Kosovës dhe Malit të Zi ka filluar implementimin e tij me datë 15.10.2013 dhe ka përfunduar me datë 14.10.2016. Pas përfundimit të TA Grantit të programit të BNK-së Kosovë - Mali i Zi është dërguar raporti final narrativ, financiar dhe raporti i auditorit të jashtëm për aprovim në Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë. Pas aprovimit të raporteve te cekura me lartë nga Zyra e BE-së në Kosovë me datë 14.12.2017 nga ky institucion kemi pranuar letrën për kthimin e mjeteve Recoveryorder) në vlerë prej 16,971.76 euro. Në bazë të Anexit II Neni 18. Recovery janë kthyer mjetet. Të bashkangjitur gjeni dëshmitë e pagesave. (Tri lëndë Komisioni European)</p> <p>Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MAPL-së dhe UNDP-së në vitin 2015.Me datë 08.07.2015 është nënshkruar Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MAPL-se dhe UNDP-se në vlerë prej 13,390.00 Dollarë dhe me datë 10.09.2015 i</p>	<p>MAPL nuk ka ofruar ndonjë dëshmi të vlefshme që ndërlidhet me këtë gjetje. Në komentet e kësaj çështje, ministria ka ofruar vetëm sqarime për të treguar mënyrën e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëfinancimit për vitet e më hershme. Gjetja jonë ka të bëjë me vitin 2018, prandaj dhe konkluzionet e auditimit mbeten të pa ndryshuara.</p>

	<p>janë bartur mjetet UNDP-se ne vlerë prej 12,172.50 euro. Të bashkangjitur gjeni Marrëveshjen ndërmjet MAPL-së dhe UNDP-së (e të njejtit format sic ishte marrëveshja konkrete) si dhe dëshminë e pagesës. (2015 UNDP)</p> <p>Marrëveshja e bashkëpunimit në mes të MAPL dhe Helvetas Swiss Intercooperation në vitin 2015.</p> <p>Me datë 20.03.2015 me numër të protokollit 0-1591/1 është nënshkruar Marrëveshja në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal do të nënshkruhet ne mes të MAPL dhe Helvetas Swiss Intercooperation.</p> <p>Me datë 04.06.2015 është nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi në mes të MAPL dhe Helvetas Swiss Intercooperation dhe me datë 20.10.2016 është bërë pagesa në vlerë prej 37,565.85 euro në emër të Helvetas Swiss Intercooperation. Mjetet e shfrytëzuara janë nga Investimet kapitale kodi 14588. Të bashkangjitur gjeni dëshminë e pagesës. (2016 DEMOS).</p>	
--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--